



## Qendra per Mirëqenien e Gruas Pejë

Pejë , 25<sup>th</sup> Maj 2016

**Gratë Kundër Dhunës Evropë (WAVE) dhe organizatat partnere ne tere Evropen kanë nisur fushaten " NGRITU "**

**Një fushatë për të drejtat e grave të mbijetuara të dhunës dhe fëmijët e tyre për të pas qasje ne mbështetje dhe mbrojtje**

1 në 3 gra në Evropë përjeton dhunë fizike ose seksuale, dhe vetëm 15 nga 46 vendet Evropiane ofrojnë shërbime të specializuara. Më shumë se 47,000 shtretër për strehimin e grave mungojnë në Evropë. Qendrat mbështetëse për përdhunim dhe sulme seksuale nuk janë në dispozicion në shumicën e vendeve. Diskriminimi i pengon gratë më të rrezikuara nga qasja për mbështetje!

"Ka një mungesës serioze të investimeve në shërbimet e specializuara mbështetëse në shumë vende në Evropës dhe si pasojë grate nuk kanë ku të drejtohen për ndihmë adekuate. Ne i bëjmë thirrje autoriteteve të BE-së, qeverive kombëtare dhe palëve të tjera të interesuara në shoqëri për ti ngritur investimet dhe për të ndaluar dhunën ndaj grave!" (Rosa Logar, kryetare e WAVE)

**Sot, rrjeti, Gratë kundër dhunës Evropë (VAWE) nis fushatën evropiane NGRITU!** Në dy vitet e ardhshme, anëtarët e WAVE do të promovojë të drejtat e grave të mbijetuara të dhunës dhe fëmijët e tyre për të pranuar mbështetje dhe mbrojtje në gjithë Evropën. Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet forma më e përhapur e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe kjo mund të jetë fatale - në vitin 2012, rreth 47% e të gjitha vrasjeve të grave janë kryer nga anëtari i familjes ose partneri intim.

Në Kosovë vetëm në periudhen Janar- Maj 2016, Koalicioni I strehimoreve të Kosoves ka strehuar 216 gra dhe femije viktime të dhunës në familje.

Ky mos-investim në mbështetje adekuate ka të bëjë me qasjen me te përhapur te fajësimit te viktimes, I cili gjithashtu eshte përgjegjës për mos-raportimin e dhunës. Shumica e shoqërive ndalojnë dhunën e tillë, por në mënyrë të heshtur e tolerojëne atë në praktikë, kështu gratë nuk kanë alternativë tjetër pos të durojnë dhunën e përsëritur. Shpenzimet e kësaj dhune të përsëritur kane ndikim tek të gjithë ne. Shërbimet mbështetëse janë jetike për të mundësuar gratë dhe fëmijët e tyre për të kërkuar siguri dhe fuqizimin për te vazhduar jeten pa dhunë. **Prandaj ne i bëjmë thirrje shoqërisë Evropiane për të ngritur investimet në shërbime të specializuara të cilat punojnë nga perspektiva e të drejtave të grave dhe të bëjëne një ndryshim. Ju lutem shikoni videon e bashkangjitur për më shumë detaje.**

Shifrat që flasin për mungesën e qasjes në shërbime të specializuara (Raporti WAVE 2015):

- Vetëm 15 nga 46 vendet evropiane të sigurojë një linjë telefonike që shkon 24/7 dhe është pa pagesë

Më shumë se 47,000 shtreter per strehimin e grave mungojnë në Evropë, veçanërisht në vendet e reja anëtare të BE-së të cilat kanë hyrë pas vitit 2004 dhe jo-të BE-së shtetet anëtare, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës

- Qendra mbështetëse për gratë dhe vajzat viktime të përdhunimit dhe dhunës seksuale nuk janë në dispozicion në shumicën e vendeve
- Qasja në shërbimet e specializuara mbështetëse pengohen për shumë gra, duke përfshirë, minoritetet, migrante, emigrante pa dokumente , gra të moshuara, dhe LGBT

**Rrjeti WAVE dhe Qendra per Mireqenien e Gruas Peje bejme thirrje vendimmarrësve kryesorë në nivel kombëtar dhe Evropian për:**

- 1) Në mënyrë aktive të mbështetes parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës kundër grave;
- 2) Te angazhohen për përmirësimin e qasjes në shërbime të specializuara mbështetëse për të gjitha gratë dhe fëmijët e tyre;
- 3) Te rris e disponueshmërinë e shërbimeve të specializuara mbështetëse në Europë (veçanërisht linjën e ndihemes se grave, strehëzat dhe qendrat);
- 4) Përmirësimimi i cilësisë së shërbimeve mbështetëse, të cilat janë të ofruara nga organizatat e pavarura te grave të cilat vendosin nevojat dhe të drejtat e grave në qendër të punës së tyre

Për shkak se dhuna ndaj grave është një problem kolektiv, i cili ka një ndikim të madh në lirinë dhe potencialin ekonomike të grave dhe pasojat e mundshme, dhe të mëdha në ekonominë botërore, fushata bën thirrje sektorit të biznesit shoqerise civile në Kosovë te

**"Ngrit investimet për të mbështetur të mbijetuarat"**

Partneriteti për ndryshim është i domosdoshem, dhe i bëjmë thirrje secilit dhe çdo njëri prej jush! Te na bashkangjitet ne kete Fushatë!

**Ngritu dhe të qëndrojmë së bashku për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe fëmijëve të tyre!**

Nga : Ardita Ramizi Bala

Drejtoreshë ne Qendren per Mireqenien e Gruas

Kryesuese e Koalicionit te Strehimoreve te Kosoves

Anetare ne WAVE- Rrjetin European Grate Kunder Dhunes Europe

-----  
Për të mësuar më shumë rreth fushatës, shkoni në: [www.wave-network.org](http://www.wave-network.org)

European Union Fundamental Rights Agency (FRA). 2014. Violence against women – an EU-wide survey. Available at: <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>

Gracia, E. and Lila, M. 2015. Attitudes towards violence against women in the EU. Available at: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/151125\\_attitudes\\_enege\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/151125_attitudes_enege_report_en.pdf)

United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC). 2013. Global study on homicide – trends, contexts, data. Available at: [https://www.unodc.org/documents/gsh/pdfs/2014\\_GLOBAL\\_HOMICIDE\\_BOOK\\_web](https://www.unodc.org/documents/gsh/pdfs/2014_GLOBAL_HOMICIDE_BOOK_web).



**WOMEN AGAINST VIOLENCE EUROPE**

WAVE Network and European Info Centre against Violence  
Bacherplatz 10/6 | 1050 Vienna | Austria  
Phone: +43 (0) 1 5482720 | Fax: +43 (0) 1 5482720 27  
E-mail: [office@wave-network.org](mailto:office@wave-network.org) | [www.wave-network.org](http://www.wave-network.org)  
ZVR: 60160859